



**UNIVERSITETI POLITEKNIK, TIRANË**  
**FAKULTETI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT**  
**DOKTORATË NË**  
**TEKNOLOGJITË E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT**  
**TIK**

*Adresa: Sheshi 'Nënë Tereza 1', Tiranë, Tel/Fax: (4) 2278160*

### Kriteret e pranimit

**Kërkesat themelore dhe procedura e regjistrimit të kandidatëve** bëhen sipas Nenit 3 të Rregullores 'Për organizimin e programeve të studimit të doktoratave', miratuar nga Senati Akademik, UT, me Vendim nr. 20, datë 13/11/2008. Për të kërkuar regjistrimin studenti duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

<b>KRITERET E PRANIMIT NE TIK</b>			
Numri minimal i studentëve	5	Numri maksimal i studentëve	12
Titujt e studimit që duhen pasur për pranim	<b>X</b> Diplomë* Master i shkencave (ose DND) në <b>Elektronikë, Telekomunikacion, Inxhinieri Informatike, FTI, UPT</b>		
	<b>X</b> Diplomë* e sistemit të vjetër – <b>Elektronikë 5-vjeçare, FIE, UPT</b>		
	<b>X</b> Diplomë ekuivalente me diplomat e cituara më lart, sipas akteve ligjore në fuqi, ekuivalentim nga MASH.		
	<b>X</b> Titull tjetër studimi: – Master i shkencave ose DND* në degë të afërta të elektronikës dhe inxhinierisë së informacionit nga FTI, UPT, ose universitetet të tjera, si: <b>Informatika</b> , por me plotësim së paku prej 10 kreditesh të caktuara nga Komiteti Shkencor i Doktoratës.		
<i>*Diplomat duhet të dëshmojnë me një <b>kopje të noterizuar të diplomës</b>, së bashku me <b>vërtetimin origjinal të notave</b>.</i>			
Kritere të tjera	-Të ketë <b>notë mesatare të peshuar të përgjithshme 8 e lart</b> në studimet e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve. -Të ketë <b>dy rekomandime</b> nga persona me titull "Profesor" të cilët njohin aftësitë akademike dhe profesionale të kandidatit. -Të zbatojë <b>standardet shkencore dhe etike</b> .		
<b>Kapërcejnë formimin e thelluar teorik</b> , duke kaluar drejtpërdrejt në fazën tjetër të programit, pra në vitin e dytë, të gjithë ata kandidatë që kanë përfunduar më parë diplomë në shkollën pasuniversitare ( <b>SHPU</b> ) në <b>Inxhinieri e Kompjuterave</b> ose në <b>Telekomunikacion dhe Inxhinieri Informatike</b> , ose diplomë MND të barasvlefshme të mbaruar në universitete të tjera jashtë vendit (të ekuivalentuar më parë nga MASH).			

Shënim:

Në përfundim të ciklit të tretë para dorëzimit të disertacionit, studenti duhet të dorëzojë dëshminë e gjuhës angleze, në përputhje me Udhëzimin e MASH nr. 14, datë 28.03.2011.



**UNIVERSITETI POLITEKNIK, TIRANË**  
**FAKULTETI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT**  
**DOKTORATË NË**  
**TEKNOLOGJITË E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT**  
**TIK**

*Adresa: Sheshi 'Nënë Tereza 1', Tiranë, Tel/Fax: (4) 2278160*

**Dosja personale e kandidatit** duhet të përmbajë dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesën me shkrim për t'u regjistruar në programin e studimit të doktoratës në të cilën theksohet propozimi për temën dhe udhëheqësin shkencor.
2. *Curriculum vitae dhe bibliografi të punimeve shkencore, të cilat duhet të jenë të dokumentuara nëse kandidati ka të tilla.*
3. Kopje e noterizuar e diplomave të ciklit të parë dhe të dytë, dhe vërtetimin origjinal të listës së notave.  
ose  
Kopje e noterizuar e diplomës së fituar jashtë shtetit, me vërtetimin origjinal të ekuivalentimit nga MASH.
4. Çertifikatë lindjeje.
5. Vërtetim origjinal të qendrës së banimit;
6. Dy rekomandime (nga dy profesorë).
7. Kopje të noterizuar të diplomave apo çertifikatave të kualifikimeve të ciklit të tretë apo të një diplome ose çertifikate ekuivalente me to shoqëruar me listën e notave apo suplementin e diplomës nëse kandidati disponon një të tillë.
8. Deklaratë e gatishmërisë së udhëheqësit shkencor për të udhëhequr kandidatin.
9. Deklaratë vetjake e studentit për përballimin e shpenzimeve të programit të studimeve të doktoratës.
10. Vendimi i departamentit për propozimin e temës studimore të zgjedhur.
11. Platforma e disertacionit. Plani i punës i ndarë në vite.
12. Vërtetim nga Qendra e punës nëse është i punësuar.
13. Mandat për tarifën e aplikimit për konkurim prej 2000 lekë.

Shënim:

Në rast të mungesës së një prej dokumentacioneve të mësipërme dosja e kandidatit nuk pranohet për shqyrtim.

Këshilli i Profesorëve